REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. 18/2021 (JR)** **Tiranë, më 8.01.2024**
**Nr. 18/2 regj.**

**SHPALLJE**
**E**
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e martë, datë 30.01.2024, ora 10:00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit me numër regjistri (JR) 18/2021, datë 14.04.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Mariana Shegani (Dedi) kundër vendimit nr. 350, datë 23.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| **Kryesuese e Trupit Gjykues** | **Ina Rama** |
| **Relatore e Çështjes** | **Rezarta Schuetz** |
| **Gjyqtare** | **Albana Shtylla** |
| **Gjyqtare** | **Mimoza Tasi** |
| **Gjyqtar** | **Sokol Çomo** |

Bazuar në nenin 49 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrimet me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Bazuar në nenin 482 paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu dhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**
**GJYQTARE**

**INA RAMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT – TIRANË – GJYKATA KUSHTETUESE – SEKRETARIA